

THE DIFFICULTIES IN SPECIFICATION OF VOCATIONAL SCHOOLS IN THE EDUCATIONAL SYSTEM OF KOSOVO

Ramadan Beqiri

College Biznesi, Prishtina, Republic of Kosovo, ramadanbeqiri@gmail.com

Abstract: The process of learning and studying in our country has been and remains one of the most crucial commitments for achieving the best results of the younger generations. Although we are aware of the difficulties in specifying vocational schools in the Kosovo education system, the process of going to the end of this regard is unstoppable and strongly committed to this challenge. The path to achieving fast-track employment is presented by establishing vocational schools that are required by local and international businesses.

From 2000 onwards, in Kosovo, there is a tendency to open schools and universities everywhere which then leads to failure of the efficiency expected. Without a proper feasibility study, several private colleges are opened, some of which did not have the priority of educating younger generations.

Many reforms are currently underway in the name of unifying educational programs with developed countries. This is why the Bologna education system has been adopted. However, if we look carefully at the employment requirements, they are not in fair relation to Kosovar graduates in their fields. To reduce unemployment and at the same time increase employment it is necessary to open specialized vocational schools according to market demand.

From the list of Accredited Institutions by the National Qualifications Authority of Kosovo (AKQA), about 34% are in foreign language and ICT programs.

Based on the findings presented in percentages and operating units we can see that the largest number of these institutions offering fast professional specialization are in the field of foreign languages and information and communication technologies (ICT).

The survey of 100 respondents revealed that 47% seek to complete rapid language training courses, 33% in ICT and 20% in other fields.

Therefore it is recommended:

Coordination of Governmental and Non-Governmental Institutions for a Common Platform in accordance with Kosovo and European Union Labor Requirements.

Greater support of Kosovo State Institutions for Businesses and Private Institutions expressing interest in developing programs for students and adults.

Ongoing support, especially in the field of Information and Communication Technology (ICT), to those companies that are profiled and working in the development of coding, software and hardware.

Teacher training for schools of all levels that focus on the required elective courses that lead to a faster process of finding a job.

Keywords: vocational schools, foreign languages, ICT, European Framework, national qualifications authority.

VËSHTRËSITË NË SPECIFIKIMIN E SHKOLLAVE PROFESIONALE NË SISTEMIN ARSIMOR NË KOSOVË

Ramadan Beqiri

Kolegji "BIZNESI" Prishtinë, Kosovë, ramadanbeqiri@gmail.com

Përmbledhje: Të mësuarit në trojet tona ka qenë dhe po mbetet një nga përkushtimet më cruciale për arritjen e rezultateve më të larta të brezave të rinj. Ndonëse, jemi të vetëdijshëm për vështirësitë në specifikimin e shkollave profesionale në sistemin arsimor në Kosovë, gërmimi në këtë drejtim është i pandalshëm dhe fuqimisht i përkushtuar për këtë sfidë. Për arritjen e punësimeve në kohë të shpejtë është përshkruar rrugëtimi për të themeluar shkolla profesionale të cilat janë të kërkuara nga bizneset vendore dhe ato ndërkombëtare.

Që nga viti 2000, në Kosovë, vërehen tendenca për të hapur gjithandej shkolla e universitete që nuk lë për të kuptuar se u arrit efikasiteti i shumëpritur. Pa një studim të mirëfillt të fizibilitetit, hapen edhe Kolegje të shumta private, që disa sosh nuk kishin në plan të parë edukimin dhe arsimimin e brezave të rinj.

Aktualisht janë bërë shumë reforma në emër të unifikimit të programeve arsimore me vendet e zhvilluara. Për këtë edhe është pranuar sistemi i arsimit, sipas Bolonjës. Mirëpo, nëse vërejmë me kujdes kërkesat e punësimeve ato nuk janë në raport të drejtë me të diplomuarit kosovarë në fushat e tyre. Për të zbutur papunësinë dhe njëherit për rritjen e punësimit nevojitet që të hapen shkolla profesionale të specializuara sipas kërkesës së tregut.

Nga lista e Institucioneve të akredituara nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve në Kosovë (AKKK), interesimi për rreth 34% është në programet gjuhë të huaja dhe TIK.

Në bazë të gjetjeve të paraqitura në përqindje dhe njësi operuese shihet se numri më i madh i këtyre institucioneve që ofrojnë specializime të shpejta profesionale është në gjuhë të huaja dhe teknologji të informacionit dhe komunikimit (TIK).

Hulumtimi i bërë me 100 respondentë sjell në pah se 47% kërkojnë të përfundojnë kurse të shpejta kualifikuese nga gjuhët e huaja, 33% në fushën e TIK dhe 20% fusha tjera.

Ndaj për këtë rekomandohet:

Koordinimi i Institucioneve qeveritare dhe joqeveritare për Platformë të përbashkët sipas kërkesave të punës në Kosovë dhe Bashkimin Evropian.

Përkrahje më e madhe e Institucioneve shtetërore të Kosovës për Biznese dhe Institucione private që shprehin interesim të zhvillojnë programe për nxënës, studentë dhe të rritur.

Përkrahje e vazhueshme, sidomos për fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), atyre kompanive që janë profilizuar dhe punojnë në zhvillimin e kodimit, softëverëve dhe hardverëve.

Trajnime për mësimdhënës të shkollave të të gjitha niveleve që kanë fokus lëndët e kërkuara zgjedhore e që sjellin deri te gjetja e shpejtë e një vendi të punës.

Fjalë kyçe: shkolla profesionale, gjuhë të huaja, TIK, Korniza evropiane, autoriteti kombëtar i kualifikimeve.

1. HYRJE

Të nxëniti është një ndër sukseset më të larta në Institucionet arsimore të të gjitha niveleve. Këtë rëndësi të pamatshme e kanë vërejtur gjenerata e gjenerata para nesh. Bazuar në historinë shqiptare për këtë kemi patur vështirësi në kontinuitet nga të gjithë ata që nëpërkëmbnin gjeneratat e reja, nga friga se edhe ne do të arrinim suksese në fusha të shkencës e teknologjisë. Përcjellja e dijës nga brezi në brez, bëhej në mënyrat më të vështira të mundshme. Për to u angazhua secili që sado pak dinte diçka, ta përcillte atë te brezi pasues. Edhe para se të dihej shkrim-leximi, dija në formë gojore është përcjellur ndër shekuj e mileniume. Grupimet zakonisht bëheshin në venbanime, me metoda tejet të thjeshta. Ndër më të organizuarat që kanë mbetë trashëgimi ishin odat shqiptare. Gojëdhanat flasin se dija përhapej me një kujdes të vaçantë dhe dosido fshehurazi. Edhe ata pak njerzë të penës, që ishin, ndiqeshin si të ishin kriminelët më të medhenj të kohës. Jetën e tyre asnjëherë nuk e kursyen, ngase e vërenin rëndësinë për nxënie të reja të kohës. Ajo që është më e freskët daton vetëm pak vite më parë. Vitet 90-ta, të shekullit XX, qenë të fundit dhe më të shprehurat kur regjimi serb mëtonte zhbërjen e shkollave shqipe në Kosovë. Ata po mbyllnin dhe ndiqnin në mënyrën më brutale nxënësit e studentët nga godinat e tyre, që me mund e djersë ishin ndërtuar ndër vite nga klasa punëtore shqiptare. Mësimdhënësit u përndoqën, burgosën e disa nga ta edhe u vranë vetëm e vetëm se po përhapnin dijen te brezat e rinj.

Mirëpo, falë ndërhyrjeve ushtarake, kjo u ndërpre në vitin 1999. Aty ishte fillimi i mëvetësisë së vërtetë të arsimit kosovar. Po fillonte një epokë e re e të nxëniti e cila pati lënë pasojë të cilat edhe më tutje po shprehen në shoqërinë tonë.

Që nga viti 2000, vërehen tendenca për të hapur gjithandej shkolla e universitete që nuk le për të kuptuar se u arrit efikasiteti i shumëpritur. Pa një studim të mirëfillt të fizibilitetit, hapen edhe Kolegje të shumta private, që disa sosh nuk kishin në plan të parë edukimin dhe arsimimin e brezave të rinj.

Dashtëm apo jo, duhet pranuar dhe nënvizuar se kemi gjenerata të cilat kanë mbaruar bachelor e master që akoma nuk kanë arrit vend pune, sidomos në fushën në të cilën kanë diplomuar.

Aktualisht janë bërë shumë reforma në emër të unifikimit të programeve arsimore me vendet e zhvilluara. Për këtë edhe është pranuar sistemi i arsimit sipas Bolonjës. Mirëpo, nëse vërejmë me kujdes kërkesat e punësimeve ato nuk janë në raport të drejtë me të diplomuarit kosovar në fushat e tyre. Për të zbutur papunësinë dhe njëherit për rritjen e punësimit nevojitet që të hapen shkolla profesionale të specializuara sipas kërkesës së tregut.

2. PËRSHKRIMI (SFONDI)

Sistemi i arsimit shkollor, sipas ligjeve në fuqi, të Kosovës më tepër deri tani i ka kushtuar rëndësi marrjen e titujve bachelor e master nga të rinjt. Por, disproporcioni në këtë drejtim: punësim – diplomë, është në shpërputhje me rezultatet e pritura. Të rinjt e Kosovës janë pajisur me tituj bachelor e master në drejtime të ndryshme duke bërë kështu mbipopullimin me kualifikime të tilla e që për to nuk ka vende pune, jo vetëm në Kosovë apo vendet përreth, por edhe në vendet e zhvilluara e po ashtu edhe në ato të bashkimit evropian (BE). Ajo që në këtë kohë kërkohet janë shkollat e specializuara profesionale të cilat përfundohen më shpejt dhe secili mund të aftësohet dhe arsimohet në mënyrën më të drejtë të mundshme për të arritur deri në vendin e vet të punës. Për këto drejtime gjithnjë e më shumë bëhen analiza profesionale me punëdhënësitë të cilët janë në kërkim të kadrove të tilla profesionale.

3. LEGJISLATURA

Në Kosovë janë në fuqi një mori ligjesh të cilat përcaktojnë arsimin dhe aftësimin profesional: Ligji nr. 04/I-138 për arsimin dhe aftësimin profesional.

Qëllimi i këtij Ligji sipas Nenit 1, është:

Të rregullojë sistemin e arsimit dhe aftësimin profesional në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Kosovës, përfshirë ndryshimet ekonomike dhe teknologjike, kërkesat e tregut të punës dhe nevojat e individëve drejt ekonomisë së tregut, duke shfrytëzuar në mënyrë optimale burimet financiare, njerëzore dhe të infrastrukturës.

Rregullon strukturën, organizimin dhe menaxhimin e institucioneve që ofrojnë arsim dhe aftësim profesional.

Sipas këtij ligji parashihet regjistrimi i institucioneve të arsimit dhe aftësimin profesional:

1. MASHT-i mban regjistrin e IAAP, ndërsa ministritë tjera mbajnë vetëm regjistrat e IAAP të themeluara nga to.
2. IAAP, të cilat ofrojnë kualifikime me njohje kombëtare akreditohen nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.
3. IAAP mbajnë statistikat për nxënësit e certifikuar dhe të diplomuar që sistemohen në tregun e punës. (<https://masht.rks-gov.net/agjencia-per-aftesim-profesional-dhe-per-te-rritur-e-kosoves>, parë më: 10.10.2019)

4. KORNIZA KOMBËTARE E KUALIFIKIMEVE (KKK)

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve është një komponentë e rëndësishme në kuadër të reformave të sistemit të kualifikimeve në Kosovë. Me këtë synohet të përmirësohet qasja në punë dhe të mësuar të mëtutjeshëm, duke u siguruar që kualifikimet të jenë në harmoni me kërkesat për punësim, t'i përmbushin kërkesat e individëve, të ekonomisë dhe institucioneve arsimore dhe aftësuese. KKK-ja do të mbështes përmirësimet cilësore në zhvillimet e kualifikimeve të cilat janë të bazuara në standarde dhe në sigurim rigoroz të cilësisë. KKK-ja ofron transparencë të sistemit të kualifikimeve kombëtare, duke qartësuar natyrën e kualifikimeve, ndërlidhjen e kualifikimeve dhe duke ofruar një bazë për arritshmëritë përgjatë të gjitha pjesëve të sistemit të edukimit. KKK-ja do të mbështesë progresin dhe lëvizshmërinë për mësim gjatë gjithë jetës, përmes shtigjeve të arsimit dhe aftësimin brenda sistemit. KKK-ja po ashtu ofron qasje për të mësuarit fleksibil, të fokusuar sipas kërkesave të individëve për punësim duke hapur mundësitë për njohjen e mësimin paraprak. KKK-ja është zhvilluar në harmoni me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK) dhe krijon bazë për bashkëpunim dhe njohje reciproke ndërmjet KKK dhe KEK. (<https://akkks.rks-gov.net/kkk/korniza-kombetare-e-kualifikimeve>, parë më: 10.10.2019)

5. KORNIZA EVROPIANE E KUALIFIKIMEVE (KEK)

KEK është një kornizë e përbashkët referuese evropiane, e cila ndërlidh sistemet e kualifikimeve të shteteve të ndryshme evropiane dhe shërben si një mjet për t'i bërë kualifikimet më të lexueshme dhe më të kuptueshme nga vendet dhe sistemet e ndryshme evropiane. Ajo i ka dy qëllime kryesore, ta promovojë lëvizshmërinë e njerëzve ndërmjet shteteve të ndryshme dhe t'ju mundësojë të mësuarit gjatë gjithë jetës. (<https://akkks.rks-gov.net/kek/korniza-evropiane-e-kualifikimeve>, parë më: 10.10.2019)

6. GJETJET

Gjatë hulumtimit në Portalin e Autoritetit Kombëtarë të Kualifikimeve (AKK), shfletojmë Listën e Ofruesve të akredituar për kualifikime sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), (në linkun: <https://akkks.rks-gov.net/kkk/ofruesit-e-akredituar-per-kualifikimet-ne-kkk>, parë më: 10.10.2019). Siç shihet në listë janë 64 Institucione të cilat kanë kaluar procesin e validimit të kualifikimeve dhe akreditimit sipas KKK.


Nga lista e Institucioneve të akredituara shihet se 11 ofrues janë për gjuhë të huaja, si: gjuhë angleze, gjuhë gjermane dhe gjuhë frënge, që operojnë në Prishtinë, Prizren, Gjiilan, Klinë e Istog, ndërsa 53 nga fusha tjera nga gjithsejt 64 të akredituara.

Nga grafikoni 1, shihet se 17% e Institucioneve të akredituara janë nga gjuhët e huaja, ndërsa 83% nga fusha tjera. Gjithsej janë 64 ofrues të shkollave profesionale.




Graf. 1. Burimi: Autori, Institucionet e akredituara për gjuhë të huaja

Nga Lista (Grafikoni 2) shihet se nga 64 IAAP, 17% janë nga teknologjia e informacionit dhe komunikimit (TIK) ndërsa 83% nga fusha tjera.




Graf. 2. Burimi: Autori, Institucionet e akredituara për TIK

Nga grafikoni 1 dhe 2 konkludojmë se në: gjuhë të huaja dhe TIK, janë së bashku 22 institucione të akredituara, përkatësisht 1/3 ose në përqindje: 34 % dhe nga fusha tjera 66 %.



Graf. 3. Burimi: Autori, përfshirja në gjuhë të huaja dhe TIK

Shtrirja e Institucioneve arsimore të akredituara nga AKKK, është: Prishtinë 30, ndërsa komuna tjera 34. Shprehja në përqindje është dhënë në grafikonin 3 dhe shtrirja në Prishtinë është 47%, ndërsa në komunat tjera 53%.



Graf. 4. Burimi: Autori, shtrirja e IAAP në Prishtinë

7. DISKUTIMI

Në bazë të gjetjeve të paraqitura në përqindje dhe njësi operuese shihet se numri më i madh i këtyre institucioneve që ofrojnë specializime të shpejta profesionale është në gjuhë të huaja dhe teknologji të informacionit dhe komunikimit (TIK). Kjo dokumentohet nga faqja zyrtare e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), (<https://akkks.rks-gov.net/>, parë më: 12.10.2019), ndërsa tabela e dhënë në MS Excel e dhënë në vegzën në linkun: (<https://akkks.rks-gov.net/kkk/ofruetit-e-akredituar-per-kualifikimet-ne-kkk>, (parë më: 13.10.2019).

Nga pyetësi që u është ofruar 100 të rinjëve nëpër komuna të ndryshme të Kosovës, që për pyetje patën:


1. Cilin trajnim të ofruar nga IAAP të akredituar nga AKK do ta ndiqnit nga këto fusha:

- Gjuhë të huaja
- TIK
- Tjera

Përgjigja ishte:

- Gjuhë të huaja 47 %
- TIK 33 %
- Tjera 20%

Paraqitja e përgjigjeve të pyetësit është dhënë në grafikoni 5.



Grafikoni 5. Burimi: Autori, Përgjigjet e pyetësit për ndjekje të programeve të akredituara

8. PËRFUNDIMI DHE REKOMANDIMI

Shkollat parauniversitare dhe Institucionet universitare (bachelor dhe master), të organizuara në Kosovë si Institucione publike dhe private, nuk kanë arritur që të nxjerrin kuadro specifike të mjaftueshme për të gjetur të diplomuarit vende pune. Ndër më të kërkuarat kohëve të fundit që kërkohen, jo vetëm nga ata në moshë adekuate, janë ato të Arsimit dhe Aftësisimit Profesional. Në këto Institucione frekuentojnë edhe të rriturit të cilët kanë përfunduar bachelor, edhe master e që nuk kanë arrit të gjejnë ndonjë vend pune.

Partnerët më të njohur që bashkëpunojnë për zhvillimin e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional në Kosovë, janë: Aleanca e Bizneseve të Kosovës (ABK), Univeristeti i Prishtinës (UP), Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), Këshilli Britanik i Kosovës (KBK), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Arsimit (MASHT), Agjencia e Akreditimit e Kosovës (AAK), Ministria e Ekonomisë dhe Finanacave (MEF), etj.

Rekomandimet që rrjedhin:

- Koordinimi i Institucioneve qeveritare dhe joqeveritare për Platformë të përbashkët sipas kërkësive të punës në Kosovë dhe Bashkimin Evropian.
- Përkrahje më e madhe e Insitucioneve shtetërore të Kosovës për Biznese dhe Institucione private që shprehin interesim të zhvillojnë programe për nxënës, studentë dhe të rritur.
- Grante dhe subvencione, sidomos për fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), atyre kompanive që janë profilizuar dhe punojnë në zhvillimin e kodimit, softëverëve dhe hardverëve.
- Trajnime për mësimdhënës të shkollave të të gjitha niveleve që kanë fokus lëndët e kërkuara zgjedhore e që sjellin deri të gjetja e shpejtë e një vendi të punës.
- Ndarje e buxhetit shtesë për mësimdhënësit e fakuleteteve në Universitetet dhe Kolegjet e Kosovës, që janë të gatshëm të ndihmojnë zhvillimin e programeve specifike nga TIK dhe fushat tjera të cilat janë të kërkuara si në Kosovë ashtu edhe jashtë saj.
- Shkurtimi i procedurave për regjistrim të Institucioneve arsimore në AKK dhe përkahje në dhënie të këshillave për procedura tejet të koklavitura për Regjistrim.

REFERENCAT

Ministria Arsimit (MASHT), <http://www.masht-gov.net>

Autoriteti Kombëtar i kualifikimeve, (AKK) <https://akkks.rks-gov.net/>

Korniza Evropiane e Kualifikeve (KEK), <https://akkks.rks-gov.net/kek/korniza-evropiane-e-kualifikimeve>

Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK), <https://akkks.rks-gov.net/kkk/korniza-kombetare-e-kualifikimeve>

Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB), <http://www.akb-ks.org/index.html>

Univeristeti i Prishtinës (UP), <https://www.uni-pr.edu/>

Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), <https://www.oek-kcc.org/>

Këshilli Britanik i Kosovës (KBK), <https://kosovo.britishcouncil.org/en>

Ministria e punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), <https://mpms.rks-gov.net/>

Agjencia e Akreditimit e Kosovës (AAK), <http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/>

Ministria e Ekonomisë dhe Finanacave (MEF), <https://mf.rks-gov.net/>

<https://aaaparr.rks-gov.net/>

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8676>

http://www.mon.gov.mk/images/documents/zakoni/Zakoni_albanski/Ligj%20p%C3%ABr%20Korniz%C3%ABn%20komb%C3%ABtare%20t%C3%AB%20kualifikimeve.pdf

<https://akkks.rks-gov.net/kkk/korniza-kombetare-e-kualifikimeve>

https://akkks.rks-gov.net/uploads/korniza_kombtare_e_kualifikimeve.pdf

<https://akkks.rks-gov.net/kkk/korniza-kombetare-e-kualifikimeve>